

KËRKESË

GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË

KËRKUESE: NEXHMIE MEMA, e bija e Hasanit, lindur në Korçë më 1953 dhe banuese në rrugën “Mihal Grameno”, pall.40, shkalla 1, apartamenti 2, Tiranë.

OBJEKTI: Shpalljen të zhdukur të bashkëshortit tim, Pëllumb Mema, lindur në Tiranë, më 06.04.1951, në bazë të neneve 15, e vijues të Kodit Civil dhe 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Sikurse rezulton nga çertifikata familjare Nr.L 1-32 datë 19.5.1999 jam bashkëshortja e Pëllumb Memës. Nga martesë nuk kemi fëmijë.

Në vitin 1991, bashkëshorti im është larguar për në Greqi sikurse mijëra shqiptarë të tjerë.

Që nga ajo kohë e deri më sot nuk kam patur asnjë komunikim me të dhe nuk di asgjë për fatin e tij, ndonëse gjatë kohës që jetonim në Tiranë kemi patur marrëdhënie shumë të mira. Kam bërë përpjekje me anën e njerëzve të mij që janë punësuar e jetojnë në Greqi, për të marrë ndonjë lajm, por nuk kam mundur.

Në datën 11 shtator 1997 në Nr.182(935) të gazetës Republika është shkruajtur një artikull me titullin: “Ka vrarë dhe djegur dy refugjatë shqiptarë, arrestohet nga policia”, në të cilin thuhet se i arrestuari Skënder Balla, banues në fshatin Qerret të Durrësit, kishte deponuar se në vitin 1991, kishte vrarë në fshatin Koropi të Athinës djemtë Pëllumb Mema e Sabit Korreshi. U interesova për këtë problem pranë prokurorisë së Durrësit, por më thanë se i arrestuari i kishte hedhur poshtë ato pohime në prokurori dhe më vonë ishte liruar për mungesë provash. Megjithë interesimin e njerëzve të mij në Greqi nuk kam mundur të marr asnjë lajm tjetër rreth bashkëshortit tim.

Në këto kushte, kërkoj që të deklarohet i zhdukur bashkëshorti im Pëllumb Mema, që më vonë të ndjek procedurat ligjore për shpalljen e tij të vdekur.

KËRKUESJA
Nexhmie Mema